



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.298/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarës së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesat e Koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të pa rregullt ankesat Anr 298/2019 Anr 299/2019 dhe Anr 300/2019 ete datës 05.10.2019 të parashtruara nga koalicioni AAK-PSD, me seli në Prishtinë, e parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

A r s y e t i m

Me datën 05.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr 298/2019 Anr 299/2019 dhe Anr 300/2019 ete datës 05.10.2019 të parashtruara nga koalicioni AAK-PSD, me të cilën ka pretenduar se Levizja Vetëvendosje (LVV) ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore, duke shpërndarë video dhe fotografi me spote publicitare të subjektit të tyre politik. Parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik LVV ka bërë shkeljen e rregullave zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me Anr.298/2019, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesat janë të pa rregullta

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesat e parashtruar nga ana koalicioni AAK-PSD janë të parregullta, sepse ankesat në fjalë nuk janë nënshkruar nga parashtruesi i ankesave dhe si tilla ankesat nuk i plotësojnë kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të

Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it Nr.02/2015 ku theksohet se *Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.*

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshteje të nenit 5.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Anr.298/2019 më datën 06.10.2019.

Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.